

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

# PROGRAMI I LËNDËS SË KËRCIMIT

SHKALLA E PARË DHE E DYTË



Qershor 2014

## Përmbajtja e Programit

I.	Hyrje .....	4
II.	Korniza konceptuale e programit.....	4
1.	Qëllimet e programit të kërcimit .....	9
2.	Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e ë .....	10
3.	Lidhja e kërcimit me temat ndërkurrikulare.....	12
4.	Lidhja e kërcimit me fushat e tjera kurrikulare.....	13
5.	Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj .....	15
6.	Ndarja e peshave për tematikë për secilën klasë.....	18
III.	Përmbajtja e shkallës së parë dhe të dytë.....	19
1.	SHKALLA E PARË.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1.1	Tematika : Gjuha dhe komunikimi i kërcimit.....	20
1.2	Tematika: Teknika dhe procese të kërcimit .....	22
1.3	Tematika: Historia, kërcimi dhe shoqëria.....	23
2.	SHKALLA E DYTË.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.1	Tematika : Gjuha dhe komunikimi i kërcimit.....	26
2.2	Tematika: Teknika dhe procese të kërcimit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.3	Tematika: Historia, kërcimi dhe shoqëria.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
IV.	Udhëzime metodologjike .....	32
V.	Udhëzime për vlerësimin .....	34
VI.	Materiale dhe burime mësimore.....	35

## **Tabelat dhe diagramat**

Digrama 1: Korniza konceptuale e programit.....	8
Digrama 2: Rezultatet e të nxënit të komptencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së kërcimit për shkallën e parë dhe të dytë. .....	11
Digrama 3: Lidhja ndërmjet kërcimit dhe fushave të tjera. ....	14
Digrama 4 : Komptencat e lëndës dhe tematikat e lëndës. ....	16
Tabela 1: Komptencat e lëndës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të lëndës .....	17
Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë.....	18

**GRUPI I PUNËS**

**Joli Eleni Gjovreku**

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulës, në të cilën përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, ku ndërveprojnë kultura dhe shoqëria.

Mësimi i arteve u afron nxënësve mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe zhvillimin e njohurive artistike përmes kuptimit të tyre nëpërmjet mjeteve shprehëse si: tingujve, ngjyrave, fjalës, lëvizjeve, të cilat mësohen, formohen dhe kultivohen përmes teknikave dhe proceseve artistike, nëpërmjet zbulimit dhe praktikës artistike, të cilat nxisin të mësuarit konkret të artit gjatë procesit mësimor në shkollë dhe në jetën e përditshme. Artet ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave që u shërbejnë individëve në aspektin personal, social dhe ekonomik dhe që lidhen me çështje lokale, kombëtare dhe globale. Kompetencat që zhvillon fusha e arteve në të gjitha shkallët kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyçe, në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Fusha e arteve zhvillohet përmes lëndëve: *art pamor, muzikë, kërcim dhe dramë* si lëndë të detyrueshme në **shkallën I, shkallën II**. Fusha e arteve **në shkallën e parë** fokusohet në ndërgjegjësimin e nxënësve për njohjen e dukurive, fenomeneve, objekteve dhe situatave artistike në mjedisin që i rrethon. **Në shkallën e dytë**, fusha e arteve fokusohet në aftësimin e nxënësve në vëzhgimin, reflektimin, komunikimin dhe përdorimin e informacionit nga burime të ndryshme.

Artet janë konceptuar në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Aspektet e të nxënësve në fushën e arteve do të zhvillojnë mundësitë e nxënësve për të njohur gjuhën artistike të arteve, për të realizuar dhe për të prezantuar punë të ndryshme artistike, për të vlerësuar veprat e arteve të ndryshme. Artet stimulojnë ndërgjegjësimin trupor, ushqejnë imagjinatën dhe kontribuojnë në zhvillimin e vetëbesimit. Fusha e arteve ndihmon në krijimin e identitetit dhe në pasurimin e botëkuptimit të nxënësve, mundëson zhvillimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar, nëpërmjet trajtimit të elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë sonë kombëtare.

## I. Hyrje

Kërcimi mund të përkufizohet si arti i përdorimit dhe i organizimit të lëvizjeve për të shprehur, komunikuar dhe krijuar. Kërcimi, si një prej disiplinave artistike brenda arteve, kërkon që ta pajisë individin me shprehitë dhe gjuhën e larmishme të lëvizjes së ngritur në art. Kërcimi i lejon njerëzit të shprehin, të komunikojnë e të kuptojnë idetë dhe ndjenjat në një mënyrë të veçantë. Kjo disiplinë i krijon mundësinë individit të krijojë marrëdhënie me veten dhe ambientin që i rrethon duke përdorur imagjinatën, intuitën dhe krijimtarinë sepse kërcimi është një mjet efikas për subjektivizmin individual dhe shoqëror. Kërcimi e përçon mesazhin e tij nëpërmjet ndjesive dhe emocioneve që ndien kërcimtari dhe ato që ndien publiku. Trupi, shqisat, ndjenjat dhe mendja janë të ndërthurura me njëra-tjetrën te një kërcimtar. Kjo ndërlidhje komplekse e bën kërcimin një përvojë unike. Me anë të mësimin të kërcimit, nxënësi ndjen magjinë dhe përsosmërinë e kërcimit. Kërcimi i lejon njerëzit të shprehin, të komunikojnë e të kuptojnë idetë dhe ndjenjat në një mënyrë të veçantë.

Njohja me kërcimin është një vlerë e rëndësishme për të mundësuar zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të punuar në mënyrë të pavarur e sistematike si dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike.

Mësimi i kërcimit zhvillon forcën krijuese te nxënësi duke i dhënë atij fjalorin dhe principet kryesore të lëvizjeve të trupit të njeriut. Nxënësit përdorin lëvizjet e ndryshme si një mjet për të komunikuar dhe për të shprehur ide të ndryshme. Duke qenë se trupi është instrumenti kryesor i kërcimit, nxënësit njohin dhe mësojnë gjithashtu se si funksionon trupi i njeriut, duke mësuar emrat e pjesëve të trupit dhe se si ai do t'u shërbejë në kërcim. Ata zbulojnë se çfarë është e mundur të bëjnë me trupin e tyre në nivele të ndryshme.

Duke krijuar kërcimet e tyre, nxënësit aktivizohen në procesin krijues dhe kanë mundësi të përdorin shumë elementë nga lëvizjet dhe teknika e kërcimit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është mundësia që kanë nxënësit për të zgjeruar njohuritë e tyre të përgjithshme kulturore nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me kërcimet e kulturave të ndryshme.

Kërcimi integrohet me të gjitha lëndët e tjera brenda fushës së arteve dhe fushat e tjera të kurrikulës, si dhe me temat ndërkurrikulare me qëllim që të zotërohen sa më mirë kompetencat kyçe. Një lidhje të ngushtë kërcimi e ka me artin e bukur të muzikës. Muzika nxit

lëvizjen dhe lëvizja krijon ritmin. Kënaqësia e të lëvizurit në kohë me muzikën është e lindur me qenien njerëzore. Shumëllojshmëritë e kërkesave dhe veprimtarive artistike të paraqitura në këtë program, udhëhiqen nga parimi *muzika, lëvizja dhe bota e brendshme*. Njohja dhe zbatimi i përmbajtjeve në lëndën e kërcimit, sigurojnë mundësinë që nxënësit me anë të lëvizjeve dhe kërcimit, *të dëgjohen, të lëvizin dhe të krijojnë*. Kërcimi përdoret në një numër të madh të aktiviteteve të përditshme ( p.sh. klasë, shtëpi, film, koncert, ngjarje të shënuara familjare, veprimtari brenda dhe jashtë shkollës, ngjarje të komunitetit etj. ). Megjithëse zbatimet e tij janë nga më të ndryshmet, ato nuk mund të kuptohen pa marrjen e disa njohurive themelore (gjuhën e trupit dhe komunikimin përmes saj, lëvizjet e trupit dhe teknikat e ndryshme të tyre, njohja me zhvillimin historik të tij) sepse këto njohuri i bëjnë të vetëdijshëm nxënësit për rolin e kërcimit në jetën e përditshme duke zgjeruar njohjen e tyre.

Në kompetencat e kërcimit realizohen një sërë detyrash të rëndësishme: nxënësi zhvillon dhe rrit trupin e tij, mëson mirë të lëvizë në hapësirë, por dhe ambientohet me disiplinën e kërcimit dhe të krijimit me anë të lëvizjeve.

Mësimi i kërcimit zhvillohet në praktikë me një ritëm energjik dhe shpjegimi i lëvizjeve të kërcimit duhet bërë në formë të qartë dhe të kuptueshme, duke mënjeluar përdorimin e termave të huaj, që shpesh janë të pakuptueshëm dhe të panevojshëm për nxënësit në të ardhmen. Me anë të kësaj lënde nxënësi/ja zhvillon plastikën e përgjithshme të trupi, gjestin artistik dhe lëvizjet artistike.

Praktika mësimore duhet të ndërtohet në atë mënyrë që në kohën më minimale të japësh lëvizjet më të rëndësishme dhe më të përdorshme. Për këtë gjë duhet të ndiqet kalimi sistematik nga më të thjeshtat te më të vështirat. Me anë të kësaj praktike nxënësi/ja edukon te vetja guximin, durimin dhe përpjekjen për të kaluar të gjitha vështirësitë që hasin në ushtrime të ndryshme që nuk mund t'i realizojnë që në fillim në mënyrën e duhur.

Që të rritet ecuria e nxënësve më të prapambetur rekomandohet të përdoret ndihma nga nxënësit më të mirë dhe të talentuar. Për çdo ushtrim ose kërcim duhet të zgjidhet muzika më përpara. Zgjedhja e muzikës së duhur ka një rëndësi shumë të madhe në detyrën e edukimit të nxënësve, u rrit atyre ndjenjën e ritmit dhe dëgjimin muzikor. Është shumë e rëndësishme të nxitësh te nxënësit interesin për procesin e krijimit artistik, që ata të vijnë në mësim me dëshirën për të punuar. Nxënësit duhet ta kuptojnë që kjo u shërben për edukimin e tyre estetik.

Kërcimi mësohet në shkallën e parë dhe të dytë të kurrikulës. Në këto shkallë mësohen njohuri mbi *lëvizjen, hapësirën, ritmin, dinamikën, gjestin, motivin*. Fëmijët provojnë këta elementë bazë, duke i kombinuar dhe ekzekutuar ato në një sërë kërcimesh të thjeshta si lojëra kërkimore – muzikore, marsh, vals, polka, kërcim popullor. Gjatë krijimit të lirë të kërcimeve nxënësit zbulojnë pjesët e trupit dhe të veprimeve që kryejnë, njohin konceptet që lidhen me lëvizjen e trupit në hapësirë, dinamikën e ndryshimit të lëvizjeve dhe bashkëveprimin e lëvizjeve në ritëm dhe nën tingujt e një muzike të dhënë, vetëm, çift, në grup, gjë e cila ndihmon në realizimin e valleve apo të kërcimeve dhe kuptojnë lidhjen e lëvizjes me muzikën.

Lënda e kërcimit synon të edukojë dhe formojë të nxënësit ndjenjën e harmonisë në kërcim, përmes njohjes me lëvizjen, ritmin, hapësirën, trupin dhe mënyrën si ai lëviz, drejt njohjes së kërcimit kombëtar dhe kërcimeve të tjera në kontekste dhe kultura të ndryshme, si dhe duke marrë pjesë dhe interpretuar në kërcimet individuale dhe në grup.

Mësimi i kërcimit në shkollë ka të bëjë me njohjen, kuptimin dhe zbatimin e koncepteve bazë të kërcimit. Kërcimi në shkollë është jo thjesht zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive përmes koncepteve bazë, por edhe një mënyrë të menduari dhe vlerësuar.

## **II. Korniza konceptuale e programit**

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë.

Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit**, për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të matematikës, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
- **Mësuesit**, për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit**, për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara, .
- **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Programi i kërcimit ka në thelbin të tij krijimin e kushteve për ndërtimin e **kompetencave të lëndës** si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet lëndës së kërcimit, është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e kërcimit dhe të gjitha arteve të tjera që përbëjnë fushën e arteve, në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e kërcimit me fushat e tjera, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.


Programi përmban 3 *tematika* të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqiten edhe **koha mësimore për secilën tematikë**, që ndryshon nga klasa në klasë.

Përdorimi i **metodologjive efikase në mësimdhënien e kërcimit** është kusht parësor për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin artistik që zotëron brenda vetes. Në këtë program **vlerësimi i nxënësve**, është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënit.

Programi i kërcimit, nga pikëpamja e organizimit të materialit, prezantohet sipas diagramit të mëposhtëm:



Digrama 1: Korniza konceptuale e programit



## 1. Qëllimet e programit të kërcimit

Programi i kërcimit, nëpërmjet përmbajtjes të përcaktuar sipas tematikave, ka si qëllim, zhvillimin e njohurive dhe koncepteve bazë për formimin artistik në kërcim, zhvillimin e inteligjencës kinetike përmes kërcimit; krijimin e mundësive për t'u shprehur dhe për të komunikuar me anë të trupit; të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimin personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve, kuptimin e vetes së tyre duke zbuluar identitetin, vlerat dhe besimet, qofshin këto personale, etnike, gjinore apo shoqërore; fitimin e vetëbesimit dhe të vetëvlerësimit, të nevojshme këto për të shpalosur veten në shumë fusha të tjera; mësimin e kërcimeve kombëtare dhe të kulturave të ndryshme, duke ndihmuar nxënësit për të mirëkuptuar dhe respektuar kultura të ndryshme, nga periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike, përfshirjen në veprimtari artistike tradicionale, duke manifestuar vlerat e kërcimit kombëtare si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar, pjesëmarrjen në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke i vënë në shërbim të mjedisit ku jeton aftësitë dhe talentin e vet, ndërveprimin në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupe të ndryshme kulturore apo etnike, zhvillimin e kompetencave në kërcim për të krijuar dhe realizuar lëvizje, kërcime dhe lojëra kërcyese - muzikore, dhënien e kontributit personal në zhvillimet artistike në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë. Ky program synon të zhvillojë te nxënësit ndjenjën e harmonisë në kërcim, përmes njohjes me lëvizjen, ritmin, hapësirën, trupin dhe mënyrën si ai lëviz, si dhe me njohjen e zhvillimit historik të kërcimit kombëtar dhe kërcimeve të tjera në kontekste dhe kultura të ndryshme.

## 2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe, me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Organizimi i mësimit të kërcimit me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën. Kur nxënësi realizon kompetencat e kërcimit, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. Psh.: *kompetenca e kërcimit "Interpretimi i lëvizjeve dhe kërcimeve"* përfshin shumë teknika të ndryshme të kërcimit, kërcime nga e tashmja dhe e shkuara apo njohjen e elementeve të ndryshëm të kërcimit të cilat fëmijët mund t'i përdorin ato në jetën e përditshme.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave në kërcim pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e përshtatshmërisë në jetë, shoqëri dhe punë.

Në zhvillimin e kompetencave të kërcimit, nxënësi gjithashtu, zhvillon kompetencat kyçe në lidhje me krijimtarinë, interpretimin, vlerësimin e kërcimit, përpunimin e informacionit për kërcimin, prezantimin e detyrave të zhvilluara, punën në grup, komunikimin efektiv etj. Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së kërcimit mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatit/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zberthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyçe për secilin vit mësimor rezultatit/et e të nxënit për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultatit/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e lëndës së kërcimit që synon të arrijë nxënësi;
- zberthen në rezultate të nxëni për kompetencat e lëndës së kërcimit për vit mësimor, rezultatit/et e të nxënit për shkallë;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të kërcimit në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në një vit mësimor;

- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënësve brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënësve për vit mësimor dhe shkallë për lëndën e kërcimit.

**Digrama 2: Rezultatet kryesore të të nxënësve sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së kërcimit për shkallën e parë dhe dytë.**

<b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në veprimtaritë artistike.</li> <li>• Kupton mesazhet që u drejtohen.</li> <li>• Shprehet në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave të kërcimit.</li> <li>• Komunikon efektivisht dhe shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe krijuese mundësitë e të shprehurit.</li> </ul>
<b>Kompetenca e të menduarit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mendon në mënyrë krijuese.</li> <li>• Merr dhe përpunon njohuritë në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.</li> <li>• Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.</li> <li>• Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.</li> </ul>
<b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përzgjedh mjetet për të realizuar një kërcim.</li> <li>• Përdor burime të ndryshme për të realizuar një kërcim</li> <li>• Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</li> </ul>
<b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërrmer nisma për të zhvilluar aktivitete artistike brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.</li> </ul>
<b>Kompetenca personale</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillon besimin tek vetja gjatë krijimit të një kërcimi.</li> <li>• Respekton punën e vet dhe të tjerëve</li> <li>• Bashkëpunon me të tjerët pamvarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.</li> </ul>
<b>Kompetenca qytetare</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</li> <li>• Zbaton rregullat e teknikave të lëvizjes së trupit, elementeve teknik, të krijimit.</li> </ul>

### **Kompetenca digjitale**

- Njeh dhe përdor mjetet magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

### **3. Lidhja e lëndës së kërcimit me temat ndërkurrikulare**

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Qasjet ndërlëndore në këtë lëndë nënkuptojnë marrëdhënien reciproke midis 2 ose më shumë lëndëve brenda një fushe apo edhe me fusha të tjera të të nxënës. Edhe kërcimi është i lidhur me lëndët brenda saj dhe me lëndë të tjera. Në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; trashëgimia kulturore; bashkëjetesa paqësore*, nxënësi kontribuon përmes aktiviteteve artistike, duke shpalosur vlerat e kulturës së vet, duke respektuar dhe promovuar vlerat e kulturave të tjera, duke bashkëpunuar vetëm dhe në grup në aktivitete të ndryshme, duke dhënë kontributin e vet, duke dhënë zgjidhje situatave dhe problemeve të ndryshme artistike, duke përdorur gjuhë të saktë artistike për të komunikuar vlera dhe qëndrime, duke shpjeguar teknika dhe lëvizje të ndryshme kërcimi që lidhen dhe me lëndë të tjera që ata mësojnë.

Në arsimin fillor, mësuesit përmes mësimin të përmbajtjeve mësimore, u japin mundësinë nxënësve të konsolidojnë përvojat me të cilat ato vijnë dhe kanë, duke i pasuruar dhe vendosur ato në një rrugë të drejtë dhe të saktë.

Nxënësi mëson të komunikojë dhe shprehet përmes gjuhës artistike të kërcimit, për të krijuar ide të ndryshme gjatë kërcimit, duke eksperimentuar dhe zhvilluar më tej idetë e veta artistike, duke organizuar krijimin e vet, sipas elementeve dhe gjuhës së kërcimit.


Nxënësi fillon të familjarizohet me lëvizjet e ndryshme të kërcimeve që janë mjaft të njohura për të, duke zbatuar teknika të ndryshme të lëvizjes, duke respektuar rregullat e kërcimit, duke ndarë përvojat e veta performuese të kërcimeve me të tjerë dhe interpretuar në mënyrë artistike.

Nxënësi analizon për kërcime të ndryshme, duke shpjeguar kuptimin e lëvizjeve në kërcime dhe duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.

#### **4. Lidhja e lëndës së kërcimit me fushat e tjera kurrikulare**

Kërcimi është i lidhur me lëndët brenda saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Kështu kërcimi dhe elementet e saj, si: hapësira, ritmi, lëvizja, dinamika, tempi etj. lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike brenda fushës së arteve, muzikën, artin pamor, teatrin, por edhe me matematikën, fizikën, shkencat shoqërore etj. Disa lidhje ndërlëndore të kërcimit me fusha të tjera janë:

**Digrama 3: Lidhja ndërmjet kërcimit dhe fushave të tjera të kurrikulës**



## **5. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj**

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e kërcimit synon të përmbushë *3 kompetencat e lëndës*, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet *3 tematikave kryesore*.

### *Kompetencat e lëndës:*

Kompetenca 1: Krijimi nëpërmjet lëvizjeve

Kompetenca 2: Performimi/interpretimi i lëvizjeve dhe kërcimeve

Kompetenca muzikore 3: Vlerësimi i lëvizjeve dhe kërcimeve

### *Tematikës e lëndës:*


Tematika 1: Gjuha dhe komunikimi i kërcimit

Tematika 2: Teknikat dhe proceset e kërcimit

Tematika 3: Historia, kërcimi dhe shoqëria



Digrama 4 : Kompetencat që formohen dhe tematikat e lëndës



**Tabela 1: Përshkrimi i kompetencave**

Kompetencat e veçanta që formohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave	Realizimi nëpërmjet tematikave
<b>Krijimi nëpërmjet lëvizjeve</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdor elementet, gjuhën dhe rregullat e kërcimit gjatë kërcimeve.</li> <li>- Demonstron përmes lëvizjeve të ndryshme kërcimin.</li> <li>- Ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <p>zbulon përmes kërcimit gjuhën e saj, shoqërimin muzikor dhe ritmik, karakterin e kërcimeve, mënyrat e kërcimit, zhvillimit të kërcimit, etj</p>
<b>Performimi/interpretimi i lëvizjeve</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Performon duke zbatuar elementët e teknikave të kërcimit .</li> <li>- Zbaton rregullat e kërcimit vetëm dhe në grup duke kuptuar elementët ekspresive të kërcimit.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <p>-zbaton teknikat e lëvizjes gjatë kërcimit, të lojërave kërcyese muzikore/popullore apo kërcimeve të tjera, zbaton rregullat dhe lëvizjet në hapësirë gjatë performimit të kërcimeve në grup, përjeton vepra të ndryshme koreografike kombëtare dhe botërore.</p>
<b>Vlerësimi i lëvizjeve dhe kërcimeve</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përjeton pjesë të vogla koreografike duke shpjeguar elementët përbërës të saj.</li> <li>- Jep mendimin apo gjykimin e tij kritik dhe estetik duke bërë lidhje midis asaj që përjeton dhe asaj që kërcen.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <p>- reagon emocionalisht ndaj lëvizjeve dhe kërcimeve duke përjetuar dhe shprehur përjetimet personale mbi një kërcim me një gjuhë të thjeshtë artistike. Prezantohet nëpërmjet kërcimit, në veprimtaritë artistike në klasë apo në ato jashtë klase.</p>

## 6. Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Lënda e kërcimit zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 0.5 orë secila, pra gjithsej 18 orë për klasën e dytë dhe 35 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 35 orë për klasën e tretë. Programi i lëndës së kërcimit specifikon peshën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuar në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

	Gjuha dhe komunikimi artistik	Teknikat dhe proceset	Historia, muzika dhe shoqëria	Gjithsej orë
<b>Klasa përgatitore</b>				XXXX orë
<b>Klasa e dytë</b>	5	10	3	18 orë
<b>Shkalla e parë</b>	5	10	3	18orë
<b>Klasa e tretë</b>	7	23	5	35 orë
<b>Shkalla e dytë</b>	7	23	5	35 orë

### III. Përmbajtja e shkallës së parë dhe të dytë

Në programin e kërcimit për shkallën e parë dhe të dytë janë paraqitur përmbajtjet e tematikave:

*Gjuha dhe komunikimi i kërcimit.*

*Teknika dhe procese të kërcimit.*

*Historia, kërcimi dhe shoqëria.*

Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri e shkathtësi dhe qëndrime e vlera. Tematikat janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxëniet, sipas kompetencave të kërcimit, për çdo shkallë të paraqitura në tabelë në fillim të çdo tematike.

Për secilën tematikë, sipas klasave të shkallës, janë paraqitur njohuritë për secilën klasë të shkallës së parë (*klasa përgatitore, klasa e dytë*) dhe shkallës së dytë (*klasa e tretë*). Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle për secilën shkallë.

Këto tematika përdoren për të realizuar rezultatet e të nxëniet të kompetencave të kërcimit për shkallë të paraqitura në tabelë në fillim të çdo tematike.

Aftësitë dhe orët e tematikave do të jenë të shpërndara në njësi mësimore të renditura logjikisht njëri pas tjetrit. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shpesh ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

Në program, për secilën klasë, afërsisht 40 % e orëve mësimore totale janë menduar për ndërtimin e njohurive të reja lëndore dhe 60 % e tyre janë menduar për krijimin e situatave të të nxëniet (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

# REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE, SIPAS TEMATIKAVE, SIPAS SHKALLËVE

## SHKALLA E PARË: KLASA E DYTË

### 1.1 Tematika : Gjuha dhe komunikimi i kërcimit

#### Përshkrimi i Tematikës:

Kjo tematikë zhvillon kuptimin për elementet e kërcimit duke filluar me lëvizjet e ndryshme të trupit ( dorë, kokë, këmbë, trup etj .) dhe kombinimet e tyre me muzikën. Përmes lëvizjeve zhvillohet ndjenja ritmike dhe melodike në bashkëveprim me lëvizjet e trupit, duke mundësuar kuptimin dhe shpjegimin e këtyre lëvizjeve me fjalë të thjeshta. Pas kuptimit të lëvizjeve ritmike dhe atyre trupore me hapa të thjeshtë, nxënësi zhvillon inteligjencën e tij kinetike duke bërë i ndërgjegjshëm për aftësitë e tij krijuese në bazë të këtyre lëvizjeve. Procese të tilla si: përjetimi, dëgjimi, kërcimi apo krijimi përmes lëvizjeve trupore, ndihmon nxënësit të zhvillojnë jo vetëm kompetencën e krijimit, por edhe të zbatimit të këtyre lëvizjeve gjatë kërcimit apo kuptimin e elementëve teknikë të kërcimit përmes njohjes konkrete dhe përdorimit të gjuhës së kërcimit në kërcime konkrete.

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi nepërmjet lëvizjes:** njeh dhe kupton lëvizjet, gjuhën dhe rregullat bazë të kërcimit dhe merr pjesë në procesin e krijimit të lëvizjeve, kërcimeve dhe lojërave kërcyese-muzikore; improvizon me lëvizjet trupore duke kuptuar rolin e tyre në kërcim; përdor gjuhën artistike për të ndarë përvojat e veta kërcyese; shpjegon elementët e kërcimit që lidhen me krijimin vet.
- **Performimi/interpretimi i lëvizjeve:** performon kërcime të thjeshta dhe përqendrohet gjatë interpretimit të kërcimit, realizon saktë elementet e thjeshta të lëvizjeve teknike të përdorura në kërcim; demonstroi elementet e kërcimit duke filluar me lëvizjet e ndryshme: dorë, kokë, këmbë, trup, gjatë krijimeve të thjeshta.
- **Vlerësimi i lëvizjeve dhe kërcimeve:** flet qartë gjatë shpjegimit të lëvizjeve të përdorura gjatë një kërcimi; fillon të përdorë një fjalor të thjeshtë të kërcimit për t'u shprehur në mënyrë artistike; shpjegon me fjalë të thjeshta përjetimet artistike.

#### KLASA E DYTË

Njohuritë për realizimin e kompetencave të

Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

lëndës	
<p><b>Lëvizjet e trupit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pozicionin e fillimit.</li> <li>- Pozicioni i përfundimit .</li> <li>- Hapat, Vrapit.</li> <li>- Kapërcimi .</li> <li>- Pozat, gjestet dhe pantomimat.</li> <li>- Figurat dhe format.</li> </ul> <p><b>Muzika, hapësira, lëvizja dhe ritmi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ritmi dhe lëvizja në muzikë.</li> <li>- Drejtimet përpara, mbrapa, majtas, djathtas.</li> <li>- Hapësira, nivelet e madhe dhe e vogël.</li> </ul> <p><b>Marrëdhënia me partnerin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pozicionet <i>përballë</i> me partnerin, <i>afër, pas njëri tjetrit</i>.</li> <li>- Veprimet përbashkëta hapsinore: afrimi qëndrimi së bashku, takimi etj.</li> <li>- Koordinimi me partnerin me lëvizje të njëjta.</li> <li>- Lëvizja në rreth.</li> <li>- Lëvizja në të njëjtën kohë.</li> </ul> <p><b>Lëvizje teknike:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbajtja e trupit.</li> <li>- Zgjatja.</li> <li>- Mbajtja drejt e kokës.</li> <li>- Lëvizje të rrjedhshme të duarve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Demonstron në mënyrën e duhur pozicionet fillestare dhe pozicionin e përfundimit të trupit.</li> <li>- Improvizon me <i>hapa</i> të ndryshëm, ritmin muzikor që dëgjon.</li> <li>- Dëgjon fragmente muzikore ose këngë për fëmijë dhe kupton shpejtësinë e ritmit, duke iu përgjigjur përmes lëvizjeve me <i>hapa normalë, hapave marsh, hapave të shpejtë, vrap etj.</i></li> <li>- Lëviz në përputhje me karakterin e muzikës me <i>hapa normalë, të shpejtë, apo vrapimit të lehtë ose të shpejtë.</i></li> <li>- Dëgjon dhe percepton <i>ritmin</i>, duke krijuar <i>figura</i> të thjeshta në hapësirë <i>rreth, në rresht (kolonë).</i></li> <li>- Krijon <i>figura të ndryshme në hapësirë</i> duke përdorur <i>hapat, vrapin</i> si psh: rreth, kollona etj.</li> <li>- Demonstron nëpërmjet <i>gjesteve dhe mimikës</i> përmbajtjen e një melodie të caktuar ( <i>e gëzueshme, festive, e shpejtë, e hidhëruar</i> ).</li> <li>- Improvizon në përshtatje me ritmin dhe melodinë, lëvizje të ndryshme trupore në hapësira të ndryshme.</li> <li>- Zhvillon <i>vëmendjen dhe kujtesën</i> për të mbajtur mend lëvizje të ndryshme që mëson.</li> <li>- Kërcen me partnerin duke respektuar lëvizjet <i>përballë me partnerin, afër, pas njëri tjetrit</i> ( këngë dhe melodi të thjeshta për fëmijë).</li> <li>- Kërcen dhe shoqëron këngët në formën e lojës kërcyese - muzikore, duke ndërthurur muzikën me lëvizjet e përbashkëta <i>duke u afruar, larguar, duke krijuar rreth me hapa të thjeshtë</i> dhe në funksion të idesë.</li> <li>- Demonstron karakteristikat e marrëdhënies me partnerin dhe lëvizjeve teknike: <i>mbajtja e trupit, zgjatja, mbajtja drejt e kokës, lëvizje të rrjedhshme të duarve.</i></li> </ul>

## 1.2 Tematika: Teknika dhe procese të kërcimit

### Përshkrimi i tematikës:

Pasi ka kuptuar njohuritë e para mbi trupin, lëvizjet e tij, ritmin, muzikën, elementët e kërcimit në këtë tematikë, ai fillon të zbatojë konkretisht përmes teknikave dhe proceseve mësimore të kërcimit këto njohuri mbi kërcimin. Proceset mësimore të kërcimit që zhvillohen në tërësi janë: kërcimi, lojërat kërcyese- muzikore, përjetimi, shikimi, improvizimi, krijimi, interpretimi.

Kryesisht kjo tematikë do të ndalet në procesin e kërcimit, interpretimit, lojërave kërcyese -muzikore, por edhe në interpretimin e tyre. Përmes interpretimit kjo tematikë ka si qëllim t'u mësojë nxënësve mënyrat e lëvizjes, mbajtjen e trupit, realizimin e elementëve kërcyese, realizimin e përmbajtjes koreografike. Mësimi i kërcimit mund të fillohet edhe nëpërmjet lojërave kërcyese - muzikore. Situatat dhe tematika e lojërave e bëjnë procesin mësimor më interesant dhe tërheqës, ku përpara nxënësve qëndrojnë detyrat muzikore, ritmike dhe kërcyese. Kështu, gjatë lojës, nxënësi mëson për ritmin, dinamikën e muzikës, si dhe i realizon ato me hapa dhe kërcime të vogla sipas muzikës.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi nëpërmjet lëvizjeve:** njeh lëvizje të thjeshta në nivele të ndryshme hapësire, ritmike dhe melodike që janë edhe elemente të gjuhës së kërcimit; kupton marrëdhënien me partnerin; zbulon dhe realizon këto elemente në kërcim dhe në lojëra kërcyese; demonstroi zbatimin e elementeve të ritmit dhe dinamikës gjatë kërcimit apo gjatë lojërave kërcyese - muzikore.
- **Performimi/interpretimi i lëvizjeve, kërcimeve dhe lojërave kërcyese - muzikore:** kërcen duke respektuar teknikën e lëvizjeve përmes rregullave të përcaktuara; interpreton etyde ose lojëra kërcyese për fëmijë; interpreton *hapa të thjeshtë të kërcimeve folklorike* duke respektuar elementet e kërcimit; performon lojërat kërcyese - muzikore duke krijuar inskenimin tyre nëpërmjet hapave, lëvizjeve të trupit, gjesteve dhe pantomimës.
- **Vlerësimi i lëvizjeve dhe kërcimeve:** shpreh qartë mendimin e vet emocional për kërcimet, lëvizjet apo lojërat kërcyese - muzikore duke përdorur një fjalor të thjeshtë të kërcimit gjatë shpjegimit; përjeton dhe analizon me fjalë të thjeshta lidhjen e muzikës me kërcimin; respekton performimin e shokëve; respekton kërcimet e kulturave të tjera.

## KLASA E DYTE

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<p><b>Lojëra kërcyese - muzikore</b> të thjeshta për fëmijë:</p> <p><b>Mjetet trupore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Duartrokitje të shuplakave.</li> <li>- Duartrokitje të shuplakave mbi gjunjë.</li> <li>- Përplasja e këmbëve.</li> <li>- Përplasja e themrave.</li> </ul> <p><b>Marsh :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hapat e thjeshtë të kërcimit .</li> <li>- Marsh <sup>1</sup>.</li> <li>- Gallop<sup>2</sup>.</li> </ul> <p><b>Vallja e pogonishtes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hapi i thjeshtë i Pogonishtes.</li> </ul> <p><b>Rregullat e kërcimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbajtja e trupit drejt.</li> <li>- Mbajtja e kokës.</li> <li>- Mbajtja e duarve.</li> <li>- Shtrirja .</li> </ul> <p><b>Kërcimi vetëm dhe me partner</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Improvizon lojëra kërcyese për fëmijë, që shoqërohen me <i>hapa, lëvizje të thjeshta trupore, gjeste dhe mimikë.</i></li> <li>- Realizon lojërat kërcyese muzikore sipas një koreografie të caktuar.</li> <li>- Shoqëron kërcimet e thjeshta me <i> mjete trupore</i> shuplaka, thembra, përplasje e këmbëve etj.</li> <li>- Improvizon hapa të ndryshëm dhe përthyerje të ndryshme të trupit nën ritmin e muzikës, marsh në kohën 2/4.</li> <li>- Kërcen <i>vetëm dhe me partner.</i></li> <li>- Kërcen dhe reagon gjatë ndryshimeve të ritmit apo karakterit muzikor nëpërmjet lëvizjeve të lira.</li> <li>- Zhvillon lëvizje të pjesëve të ndryshme të trupit në hapësirë në sinkron me muzikën.</li> <li>- Improvizon hapa të thjeshtë të kërcimit marsh, duke ndjekur ritmin dhe melodinë e muzikës: Wedding marsh – F. Mendelson; Marshi turk- V.A.Moxart.</li> <li>- Realizon fragmente shumë të shkurtra të kërcimit, duke përdorur <i>trupin dhe hapat</i> në mënyra të ndryshme: <i>duke rrëshqitur, duke kërcyer, duke lëvizur kokën në drejtime të ndryshme,</i> etj.</li> <li>- Kryen <i>lëvizje të lira</i> sipas karakterit të muzikës që dëgjon në një hapësirë të caktuar.</li> <li>- Demonstron <i>hapat e marshit</i> nën shoqërimin e muzikës.</li> <li>- Demonstron <i>hapat e pogonishtes</i> nën shoqërimin e muzikës.</li> <li>- Respekton <i>rregullat e kërcimit</i> gjatë kërcimeve të ndryshme <i>trupi, koka, duart, shtrirja e këmbëve.</i></li> </ul>

### 1.3 Tematika: Historia, kërcimi dhe shoqëria

<sup>1</sup> Marsh i thjeshtë në kohën 2/4.

<sup>2</sup> Gallop hap kërcyese i marshit dhe Polkës.



**Përshkrimi i tematikës:** Zbulimi i njohurive të para mbi trupin, lëvizjet e tij, ritmin, muzikën dhe elementët e kërcimit, u jep mundësinë nxënësve të fillojnë të kuptojnë karakteristikat, të veçantat dhe të përbashkëtat që kanë kërcimet nga njëra-tjetra.

Kuptojnë ndikimin e kërcimit në shoqëri. Përmes mësimit të hapave të dy kërcimeve shumë të thjeshta *marshit* apo valles folklorike *Pogonishtes* ata kuptojnë ndryshimet *ritmike, muzikore, lëvizore* midis tyre. Në të njëjtën kohë nxënësi kupton rolin që ka kërcimi në aktivitetet e ndryshe në shkollë dhe jashtë saj.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:**

- **Krijimi nëpërmjet lëvizjeve:** provon të gjejë në fragmente të ndryshme muzikore ndryshimet në karakterin e muzikës; provon të improvizojë lëvizje të ndryshme, duke lidhur muzikën dhe lëvizjen me një personazh apo figurë të caktuar; improvizon përmes lëvizjeve duke dhënë gjendjen e caktuar me anë të *gjuhës së kërcimit, gjesteve dhe pantomimës*.
- **Performimi/interpretimi i lëvizjeve dhe kërcimeve:** performon / interpreton kërcimet *marsh, vallen pogonishte* me të gjitha karakteristiket *ritmike, muzikore, lëvizore*; respekton gjatë kërcimit hapat e thjeshtë bazë të tij; vlerëson interpretimin dhe performimin e të tjerëve; ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.
- **Vlerësimi i lëvizjeve dhe kërcimeve:** bën lidhje ndërmjet asaj që ndien dhe asaj që dëgjon përmes një kënge, loje kërcyese - muzikore apo vepre koreografike; bën gjykime kritike dhe estetike ndaj një kërcimi të caktuar; ndan përvojën/mendimin e vet me të tjerët; shpreh qartë mendimin e vet emocional për kërcimet apo lojërat kërcyese - muzikore duke përdorur elementet e kërcimit gjatë shpjegimit; përjeton muzikën dhe përdor lëvizje të thjeshta për të improvizuar mbi të; respekton mendimin e shokëve; respekton pjesë koreografike të kulturave të tjera, merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

**KLASA E DYTË**

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<b>Kërcimi dhe estetika</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kupton se kërcimi shprehet përmes lëvizjes dhe shpreh: <i>dashuri, keqardhje, gëzim, shpresë, mërzi</i>.</li> <li>- Komenton me fjalë të thjeshta kërcimet që shikon duke përdorur një fjalor të thjeshtë si: kërcim i bukur, më pëlqen etj.</li> <li>- Shpjegon emocionin që i krijon lëvizja ndërthurur me muzikën dhe ritmin në një kërcim të caktuar.</li> </ul>

- Shpreh emocionet për kërcimin që realizon apo përjeton.
- Vlerëson performimin e shokut dhe të shoqes gjatë një improvizim/kërcimi të thjeshtë.
- Shikon vepra koreografike të huaja ose shqiptare, dhe diskuton, duke përdorur fjalor të thjeshtë: *e gëzueshme, e qetë, marsh, e shpejtë, e ngadaltë, e qetë* etj.

**Qëndrime dhe vlera:**

- Paraqet kuriozitet për lëvizjet e trupit në jetën e përditshme.
- Kërkon dhe zbulon lëvizje trupore që mund t'i realizojë me pjesë të ndryshme të trupit, duke shprehur mendimin e vet përmes këtyre lëvizjeve.
- Kupton ndikimin e ritmit dhe muzikës në shprehjen e lëvizjeve.
- Shpreh idetë e veta për kërcimin.
- Shprehet artistikisht për një kërcim.
- Demonstron vetëbesim në aktivitete të ndryshme artistike.
- Ka dëshirë për tu shprehur dhe komunikuar në mënyrë të pavarur.
- Merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike vetëm dhe me partner.
- Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për të krijuar dhe interpretuar.
- Demonstron këmbëngulje në krijimet koreografike.
- Bashkëpunon vetëm dhe me të tjerë në një veprimtari artistike.
- Respekton diversitetin ndaj kulturave të ndryshme.
- Demonstron respekt për veten dhe të tjerët.
- Mban qëndrim ndaj kërcimeve si *marshit, poganishte dhe lojërave kërcimore- muzikore*.
- Njeh dhe respekton trashëgiminë kulturore kombëtare dhe trashëgiminë e kulturave të tjera.
- Demonstron frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë kërcimit apo krijimit nëpërmjet lëvizjeve.
- Demonstron përqendrim dhe durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese.

## REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE, SIPAS TEMATIKAVE, SIPAS SHKALLËVE

### SHKALLA E PARË: KLASA E TRETË

#### Tematika : Gjuha dhe komunikimi i kërcimit

##### Përshkrimi i tematikës:

Kjo tematikë zhvillon më tej kuptimin për elementet e tjerë të kërcimit të lëvizjeve të trupit, tempit, dinamikës së lëvizjes, energjisë, marrëdhënies me grupin, lëvizjeve teknike, hedhjeve, lëkundjet, rrotullimeve me një dhe dy këmbë, gjestet simbolike, figurave, formave rrethore, zigzag etj. Njohja dhe përforsimi i marrëdhënies me partnerin ose dhe me grupin është shumë e rëndësishme në këtë fazë të kërcimit. Ndjenja ritmike dhe melodike si dhe njohja më e thellë e lëvizjeve dhe kërcimit bëhet tashmë nëpërmjet njohjes së pozicioneve të lëvizjeve në kërcime konkrete polka dhe vals dhe zbatimit të rregullave të tyre.

##### Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi nëpërmjet lëvizjes:** njeh dhe kupton lëvizjet, gjuhën dhe rregullat bazë të kërcimit dhe merr pjesë në procesin e krijimit të lëvizjeve, kërcimeve dhe lojërave kërcyese-muzikore; improvizon me lëvizjet trupore duke kuptuar rolin e tyre në kërcim; përdor gjuhën artistike për të ndarë përvojat e veta kërcyese; shpjegon elementët e kërcimit që lidhen me krijimin vet.
- **Performimi/interpretimi i lëvizjeve:** performon kërcime të thjeshta dhe përqendrohet gjatë interpretimit të kërcimit, realizon saktë elementet e thjeshta të lëvizjeve teknike të përdorura në kërcim; demonstroi elementet e kërcimit duke filluar me lëvizjet e ndryshme: dorë, kokë, këmbë, trup gjatë krijimeve të thjeshta.
- **Vlerësimi i lëvizjeve dhe kërcimeve:** flet qartë gjatë shpjegimit të lëvizjeve të përdorura gjatë një kërcimi; fillon të përdorë një fjalor të thjeshtë të kërcimit për t'u shprehur në mënyrë artistike; shpjegon me fjalë të thjeshta përjetimet artistike.

### KLASA E TRETË

Njohuritë për realizimin e Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

kompetencave të lëndës.	
<p><b>Lëvizjet e trupit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hedhje e madhe.</li> <li>- Rënie .</li> <li>- Lëkundjet.</li> <li>- Rrotullimet me një dhe dy këmbë.</li> <li>- Gjestet simbolike.</li> <li>- Figurat dhe format rrethore dhe zigzag.</li> </ul> <p><b>Tempi dhe dinamika e lëvizjes:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëvizje me temp të: <i>ngadaltë, shpejtë, mesatar.</i></li> <li>- Lëvizje dinamike të forta, të qeta, shumë të forta, shumë të qeta.</li> </ul> <p><b>Energjia:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëvizje të kryera: <i>me kontraktim, të menjëhershme, me pak energji, me shumë energji, me thekse dinamike.</i></li> </ul> <p><b>Marrëdhënia me grupin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pozicionimi: <i>në rreth, në një vijë, në radhë.</i></li> <li>- Lëvizjet <i>në unison me grupin dhe të alternuara me partnerin e grupin</i></li> </ul> <p><b>Lëvizje teknike<sup>3</sup></b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kupton rëndësinë e lëvizjeve trupore në një kërcim dhe momentin kur përdoren ato: <i>hedhje e madhe, rënie , lëkundjet, rrotullimet me një dhe dy këmbë, gjestet simbolike.</i></li> <li>- Kupton në një kërcim të caktuar <i>figurat, format rrethore dhe zigzag.</i></li> <li>- Krijon <i>figura</i> të ndryshme në hapësirë, duke përdorur <i>hedhjet, rënien lëkundjet, rrotullimet.</i></li> <li>- Krijon përmes lëvizjeve të alternuara me njëra- tjetrën improvizime të ndryshme kërcyese .</li> <li>- Provon të shprehë emocione të ndryshme me <i>lëvizjet e trupit</i> dhe me <i>gjestet.</i></li> <li>- Zbulon dhe përjeton shumëllojshmëri <i>tempesh dhe lëvizjesh dinamike,</i> nga kërcime dhe muzikë të ndryshme.</li> <li>- Përjeton dhe percepton dinamikën si fenomen muzikor duke krijuar <i>figura në hapësirë.</i></li> <li>- Kupton llojet e lëvizjeve të realizuara me energji të ndryshme <i>me kontraktim, të menjëhershme, me pak energji, me shumë energji, me thekse dinamike.</i></li> <li>- Kupton marrëdhëniet në grup gjatë kërcimit nëpërmjet respektimit të: pozicionimit: <i>në rreth, në një vijë, në radhë</i> dhe lëvizjeve <i>në unison me grupin dhe të alternuara me partnerin e grupin</i></li> <li>- Improvizon në përshtatje me ritmin dhe melodinë, tempit dhe dinamikës së muzikës , lëvizje të ndryshme trupore në hapësira të ndryshme dhe nivele të ndryshme hapësinore.</li> <li>- Kupton karakteristikat e marrëdhënies me grupin dhe lëvizjeve teknike që krijohen gjatë kërcimit.</li> <li>- Kërcen duke improvizuar dhe ndërthurur muzikën me lëvizjen e përbashkëta duke u afruar, larguar, duke krijuar figura të ndryshme në hapësirë me hapa të thjeshtë.</li> <li>- Zhvillon vëmendjen dhe kujtesën për të mbajtur mend lëvizje të ndryshme që shikon.</li> <li>- Kupton dhe provon <i>lëvizje teknike</i> të tilla si: mbajtjen e trupit dhe frymëmarrjen shtrirë, ulur</li> </ul>

<sup>3</sup> Lëvizje teknike: janë të gjitha lëvizjet që realizohen me rregulla të caktuara.

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbajtja e trupit dhe frymëmarja shtrirë, ulur dhe në këmbë.</li> <li>- Zgjatja e këmbëve dhe shtirja e tyre.</li> <li>- Palosjet e trupit.</li> <li>- Lëvizja e koordinuar e duarve dhe këmbëve.</li> <li>- Transferimi i peshës së trupit nga një këmbë në tjetrën.</li> </ul>	<p>dhe në këmbë; zgjatjen e këmbëve dhe shtrirjen e tyre; palosjet e trupit; lëvizjet e koordinuara të duarve dhe këmbëve; transferimin e peshës së trupit nga një këmbë në tjetrën.</p>
--	--

#### 1.4 Tematika: Teknika dhe procese të kërcimit

##### **Përshkrimi i tematikës:**

Tematika thellon më tej njohjen mbi lëvizjen dhe kërcimin e marsheve, polkës dhe valsit. Kjo tematikë ka si qëllim t'u mësojë nxënësve mënyrat e lëvizjes, mbajtjen e trupit, realizimin e elementëve bazë kërcyes të kërcimeve të thjeshta. Mësimi i kërcimit mund të fillohet edhe me hapa të thjeshta të improvizuara me muzikën e këtyre kërcimeve. Improvizimi me hapa të ngjashëm të valsit dhe polkës dhe kalimi më pas në mësimin e tyre, duke kuptuar dhe respektuar rregullat e kërcimit të tyre, mundësohet pikërisht nga kjo tematikë.

Performimi dhe interpretimi i kërcimeve është shumë i rëndësishëm në zhvillimin e kënaqësisë që jep kërcimi, në prezantimin që nxënësit do të bëjnë në vende të ndryshme: në klasë, shkollë, familje apo kudo.

##### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:**

- ***Krijimi nëpërmjet lëvizjeve:*** demonstroi kuptimin e lëvizjeve të thjeshta në nivele të ndryshme të hapësirës ; kupton marrëdhënien me partnerin; zbulon dhe realizon këto elemente në kërcim dhe në lojëra kërcyese; demonstroi zbatimin e elementeve të ritmit dhe dinamikës gjatë kërcimit të *valsit apo polkës* apo gjatë lojërave kërcyese - muzikore.
- ***Performimi/interpretimi i lëvizjeve dhe kërcimeve:*** kërcen duke respektuar teknikën e lëvizjeve përmes rregullave të

përcaktuara; performon lojërat kërcyese - muzikore duke krijuar inskenimin tyre nëpërmjet hapave, lëvizjeve të trupit, gjesteve dhe pantomimës, interpreton kërcime ose lojëra kërcyese për fëmijë; performon / interpreton *hapa të thjeshtë të kërcimeve: vals, polka, kërcime folklorike* duke respektuar elementet e kërcimit.

• **Vlerësimi i lëvizjeve dhe kërcimeve:** shpreh qartë mendimin e vet emocional për kërcimet e mësuara, duke përdorur një fjalor të thjeshtë të kërcimit gjatë shpjegimit; përjeton dhe analizon me fjalë të thjeshta lidhjen e muzikës me kërcimin; respekton performimin e shokëve; respekton kërcimet e kulturave të tjera.

### KLASA E TRETË

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës.	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës.
<p><b>Polka<sup>4</sup>:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Polka në vend.</li> <li>- Polka me zhvendosje përpara ose mbrapa.</li> <li>- Polka në çift.</li> <li>- Polka me rrotullim.</li> </ul> <p><b>Valsi<sup>5</sup>:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vals në vend.</li> <li>- Vals me zhvendosje përpara dhe mbrapa.</li> <li>- Vals me rrotullim.</li> </ul> <p><b>Rregullat e kërcimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pozat e fiksuara.</li> <li>- Mbajtja e duarve.</li> <li>- Mbajtja e këmbëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Reagon nëpërmjet <i>lëvizjeve të ndryshme trupore</i> dhe <i>hapave</i> sipas muzikës që dëgjon.</li> <li>- Zhvillon lëvizjen kërcimit dhe trupit në hapësirë sipas dinamikës së muzikës.</li> <li>- Improvizon hapa të ngjashëm me hapat e polkës vetëm, me partner dhe në grup.</li> <li>- Improvizon hapa të ngjashëm me hapat e valsit vetëm, me partner dhe në grup.</li> <li>- Dallon hapat e valsit nga hapat e polkës nga ndryshimi i performimit të hapave dhe nga ndryshimi i ritmit muzikor 2/4 polka dhe 3/4 vals.</li> <li>- Improvizon në përshtatje me ritmin dhe melodinë, tempit dhe dinamikës së muzikës, lëvizje të ndryshme trupore në hapësira të ndryshme dhe nivele të ndryshme hapësinore.</li> <li>- Dëgjon, përjeton dhe percepton dinamikën si fenomen muzikor duke krijuar <i>figura në hapsirë personale</i>.</li> <li>- Provon shumëllojshmëri muzikë polkash dhe valsesh nga kompozitorë të ndryshëm.</li> <li>- Realizon kërcime të <i>polkës</i>, vetëm, me partner dhe në grup.</li> <li>- Realizon kërcime të <i>valsit</i> vetëm, me partner dhe në grup.</li> <li>- Respekton rregullat bazë të polkës dhe valsit gjatë kërcimit si: trupi, koka, duart, marrëdhënia</li> </ul>

<sup>4</sup> Polka: kërcim I thjeshtë i shek 19, me muzikë në kohën 2/4

<sup>5</sup> Valsi: kërcim i shek 19, me muzikë në kohën 3/4

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Respektimi i hapsirës së tjetrit.</li> <li>- Përshëndetjet në kërcim.</li> </ul>	me partnerin ose grupin, përshëndetja etj.
---	--

## 1.5 Tematika: Historia, kërcimi dhe shoqëria

<p><b>Përshkrimi i tematikës:</b></p> <p>Njohja me kërcime të ndryshme u jep mundësinë nxënësve të fillojnë të kuptojnë karakteristikat, të veçantat dhe të përbashkëtat që kanë kërcimet nga njëra- tjetra. Kërcimi është nga artet më të lashta i cili mjet shprehës ka lëvizjen. Kuptimi i elementeve kërcyese, mënyra se si bashkëvepron lëvizja me ritmin dhe melodinë, si harmonizohen lëvizjet qoftë me partnerin apo në grup, si krijohen emocionet nga kërcime të kulturave të ndryshme, dhe shpjegimi i tyre i zhvillon pikërisht kjo tematikë. Kuptojnë ndikimin e kërcimit në shoqëri dhe rolin që ka kërcimi në aktivitetet e ndryshme në shkollë dhe jashtë saj.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Krijimi nëpërmjet lëvizjeve:</b> provon të gjejë ndryshimet në karakterin e muzikës dhe provon të improvizojë mbi këtë muzikë, duke dhënë gjendjen e caktuar me anë të gjuhës së kërcimit, gjesteve dhe pantomimës.</li> <li>• <b>Performimi/interpretimi i lëvizjeve, kërcimeve dhe lojërave kërcyese -muzikore:</b> performon/ interpreton lojëra kërcyese – muzikore, kërcime duke respektuar rregullat dhe karakteristikat e tyre; respekton gjatë kërcimit hapat e thjeshtë bazë të tij; vlerëson interpretimin dhe performimin e të tjerëve; ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.</li> <li>• <b>Vlerësimi i lëvizjeve dhe kërcimeve:</b> bën lidhje ndërmjet asaj që ndjen dhe muzikës që dëgjon dhe një veprë koreografike; bën gjykime kritike dhe estetike ndaj një kërcimi të caktuar; ndan përvojën/mendimin e vet me të tjerët; shpreh qartë mendimin e vet emocional për lojërat kërcyese - muzikore dhe kërcime, duke përdorur gjuhën e kërcimit gjatë shpjegimit; përjeton muzikën dhe e kërcimeve të ndryshme; respekton mendimin e shokëve; respekton pjesë koreografike të kulturave të tjera; merr pjesë në aktivitet të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.</li> </ul>	
<p><b>KLASA E TRETË</b></p>	
<p><b>Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës</b></p>	<p><b>Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës</b></p>

<p><b>Historia e polkës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Polka.</li> </ul> <p><b>Historia e valsit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Weding marsh – F. Mendelson.</li> </ul> <p><b>Kërcimi tradicional:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Vallja pogonishtes.</li> <li>-Valle të krahinës së vet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dallon kërcimin e polkës nga valsi nga lëvizjet, muzika dhe historiku i tyre.</li> <li>- Komenton kërcime të ndryshme tradicionale, duke komentuar elemente të ndryshëm të kërcimit: lëvizjet, gjestet, kërcimtarët që marrin pjesë, veshjet etj.</li> <li>- Komenton me fjalë të thjeshta kërcimet që shikon apo kërcen (<i>shpejt, ngadalë, ëmbël e bukur, e mërzitshme</i>).</li> <li>- Shpreh emocionet për kërcime të ndryshme tradicionale dhe klasike, që realizon apo shikon.</li> <li>- Vlerëson performimin / interpretimin e shokut dhe të shoqes gjatë realizimit të një pjese koreografike.</li> <li>- Shikon vepra koreografike të huaja ose shqiptare, dhe diskuton, duke përdorur fjalor të thjeshtë.</li> </ul>
<p><b>Qëndrime dhe vlera:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Paraqet kuriozitet për kërcimet dhe autorët e ndryshëm.</li> <li>- Eksploron dhe zbulon lëvizjet, hapat dhe kërcimet duke shprehur mendimin e vet ndaj këtyre elementëve.</li> <li>- Kupton karakteristikat e valsit dhe polkës dhe emocionet që krijojnë ato.</li> <li>- Shpreh idetë e veta për kërcimet .</li> <li>- Shprehet artistikisht për një pjesë koreografike.</li> <li>- Demonstron vetëbesim në aktivitete të ndryshme artistike.</li> <li>- Ka dëshirë për tu shprehur dhe komunikuar në mënyrë të pavarur.</li> <li>- Merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike vetëm dhe në grup.</li> <li>- Përdor imagjinatën për të krijuar dhe interpretuar.</li> <li>- Demonstron këmbëngulje në krijimet nëpërmjet lëvizjeve.</li> <li>- Bashkëpunon vetëm dhe me të tjerë në një veprimtari artistike.</li> <li>- Respekton diversitetin ndaj kulturave të ndryshme.</li> <li>- Demonstron respekt për veten dhe të tjerët.</li> </ul>	



- Mban qëndrim ndaj kërcimeve dhe lëvizjeve të tyre.
- Njeh dhe respekton trashëgiminë kulturore kombëtare dhe trashëgiminë e kulturave të tjera.
- Demonstron frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë lëvizjeve apo kërcimit.
- Demonstron përqendrim dhe durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese.

#### **IV. Udhëzime metodologjike**

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënit të kërcimit është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin artistik që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimin të kërcimit do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike artistike, ku ata përjetojnë dhe mësojnë elementët dhe rregullat e kërcimit.

Mësimdhënia e kërcimit, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike jo gjithmonë të vetëdijshme për nxënësit e kësaj grupmoshe. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore e kërcimit, është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit, të cilët drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual/artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia e kërcimit, synon gjithë përfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet në mësimdhënien e nxënien bazuar në kompetenca; mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar.

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e kërcimit mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënit të kërcimit;

- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin e aftësive bazë të lëvizjes;
- rëndësinë e zbatimeve praktike të kërcimit, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet e kërcimit me situata të jetës reale;
- rëndësinë e përdorimit të mjeteve të kërcimit konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- veçoritë e interpretimit në mënyrë individuale dhe në grup;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së kërcimit dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie e mirë menduar dhe e mirë planifikuar, krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat e kërcimit dhe jo vetëm te kjo lëndë, janë të përcaktuara në këtë program, janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Ata janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime/performime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në kërcim.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi të punojë me situata ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si “..pse më pëlqen ky kërcim?”, “...a është i bukur dhe kërcyes?”, “..çfarë ndodh nëse e kërcëjmë më shpejt?” etj. Në këtë mënyrë ai inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e tij dhe të ndërmarrë situata të reja.

Projektet kurrikulare afatgjata lejojnë nxënësin të aplikojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integruese me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj.

## V. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi, i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësitë për mirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Sigurisht është i domosdoshëm edhe vlerësimi i përmbajtjes lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive në kërcim nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (*psh. vetvlerësimi, interpretim i etydeve të karaktereve të ndryshme dhe lojërash kërcimore- muzikore, portofol me punë artistike, pjesëmarrja në një aktivitet artistik etj.*)

Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi. Në kërcim, ndryshe nga lëndët e tjera, mbështetet në parimin e individualizimit, ku çdo nxënës posedon dhe zhvillon prirje të veçanta, duke u shprehur në mënyrë individuale. *Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale dhe krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi* i punëve koreografike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte. Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënit dhe objekt i vlerësimit janë krijimi i kompetencave të kërcimit të nxënësve, në përmes *krijimit, performimit/interpretimit dhe vlerësimit artistik*. Arritjet në fushën e kërcimit dhe të arteve janë më shumë individuale, prandaj duhet edhe të vlerësohen si të tilla.

Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes *të kërcyerit, realizimit teknik, të krijuarit, të analizuarit të lëvizjeve dhe kërcimeve* etj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstrojnë arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme.

Vlerësimi i nxënësve në shkallën e parë dhe të dytë bëhet sipas kompetencave përkatëse që ata duhet të zhvillojnë.

## **VI. Materiale dhe burime mësimore**

Gjatë mësimit të kërcimit për realizimin e kompetencave, mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon ambiente për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në kërcim duke ndihmuar nxënësit të eksplorojnë kërcime, lojëra kërcyese - muzikore, vepra të thjeshta koreografike, duke zhvilluar aftësitë e tyre në mësimin e tyre.

Mësuesi përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore dhe me një fjalor të saktë të gjuhës artistike koreografike. Mësuesi siguron qasje përmes materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit dhe ju prezanton/sqaron nxënësve përmbajtjet caktuar ose shkathtësitë që ata duhet të performojnë në kërcim.

Kërcimi studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike të kërcimit, p.sh.: shikim të shfaqjeve për ndjekjen e pjesëve koreografike TV dhe DVD, për muzikën përdoren magnetofoni dhe CD.

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, interneti etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Mjetet audio vizive si:* TV, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- *Mjetet verbale, tekstet si:* libri i mësuesit, albume që mund të përdoren në shkollë dhe demonstruar vepra të ndryshme artistike. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për kërcimin. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në kryerjen e krijimeve të ndryshme.
- *Mjedisi mësimor si:* (klasa, kabinetet e kërcimit etj.)